



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 768/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.11.2018, shqyrtoi ankesat me:

- Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Inerti” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Rikonstruksion i godinës së ARSSH-së*”, me nr. REF-77899-07-04-2018, me fond limit 33.312.381 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.08.2018, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Inerti” sh.p.k.
Rr. “5 Maji”, Pallati “Inerti”, H.2, K.6, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Rrugor Shqiptar.
Rr. “Sami Frashëri”, Nr.33, Tiranë
- Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k.
Rr. “Frederik Shiroka”, Nd.6, H.10, Ap 4, Njësia Bashkiake Nr.7, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.07.2018 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Rikonstruktion i godinës së ARSSH-së”, me nr. REF-77899-07-04-2018, me fond limit 33,312,381 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.08.2018, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datën 10.08.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 28.08.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|---------------------------------------|----------------------------------|
| 1. ”Shkëlqimi 07” sh.p.k. | 23.429.180 lekë, skualifikuar |
| 2. ”Llazo” sh.p.k. & ”Aluera” sh.p.k. | 25.158.341 lekë, skualifikuar |
| 3. ”Eurondërtimi 2000” sh.p.k. | 25.856.318 lekë, skualifikuar |
| 4. ”Inerti” sh.p.k. | 26.988.247 lekë, skualifikuar |
| 5. ”Curri” sh.p.k. | 27.214.992 lekë, skualifikuar |
| 6. ”Bajrami-N” sh.p.k. | 27.306.746,99 lekë, skualifikuar |
| 7. ”Ndregjoni” sh.p.k. | 27.429.140 lekë, skualifikuar |
| 8. ”Boshnjaku B” sh.p.k. | 27.500.000 lekë, skualifikuar |
| 9. ”B-93” sh.p.k. | 28,.100.105 lekë, skualifikuar |

10. "Be-Is" sh.p.k.	28.190.775 lekë, skualifikuar
11. "S.M.O Union" sh.p.k.	29.446.595 lekë, skualifikuar
12. "Aurora Konstruksion" sh.p.k.	29.791.970 lekë, skualifikuar
13. "Blerimi" sh.p.k. & "Ergi" sh.p.k.	30.000.000 lekë, skualifikuar
14. "Senka" sh.p.k	30.645.727 lekë, skualifikuar
15. "Ed Konstruksion" sh.p.k.	31.652.091,45 lekë, kualifikuar
16. "Company Riviera 2008" sh.p.k.	32.240.859 lekë, kualifikuar
17. "O.B Konstruksion" sh.p.k.	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.4. Në datën 28.08.2018, operatori ekonomik "Inerti" sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyet si më poshtë vijon:

"Operatori ekonomik Inerti shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:

Nuk eshte permbushur pika: 2.3.1 Si staf inxhinierik (drejtues teknikë) të përfshirë në licencën e shoqërisë të jenë: ...1 Arkitekt. Sipas dokumentacionit te paraqitur, licences se shoqerise pjesemarrese ne kete procedure, rezulton qe nuk ka si drejtues teknik, minimalisht 1 arkitekt, shoqeruar me kontraten e punës, diplomem dhe CV-të, kjo ne kundershtrim me kriterin e dhene ne dokumentet e tenderit.

Nuk eshte permbushur pika: 2.3.3 Si dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë ...Impiant prodhim betoni me QKL, pronësi ose qira, copë 1; Impiant prodhim inertesh me QKL, pronësi ose qira, copë 1. Sipas dokumentacionit te paraqitur, te shoqerise pjesemarrese ne kete procedure, rezulton qe per keto kapacitete teknike jane paraqitur kontrata furnizimi, kjo ne kundershtrim me kriterin e dhene ne dokumentet e tenderit"

II.5. Në datën 04.09.2018 operatori ekonomik ankimues "Inerti" sh.p.k ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, me argumentimin si më poshtë vijon:

"[...] Ne arsyet e skualifikimit te shoqerise "Inerti" shpk, Autoriteti Kontraktor ka pretenduar se nuk eshte permbushur kriteri i pikes 2.3.1 ne te cilin citohej shprehimisht:

Si staf inxhinierik (drejtues teknikë) të përfshirë në licencën e shoqërisë të jenë:

1 Ing.Ndërtimi

1 Ing. Elektrik

1 Ing. Hidroteknik

1 Ing. Mjedisi

1 Ing. Mekanik

1 Arkitekt

Të paraqiten: kontratat e rregullta të punës, diplomat dhe CV-të. Ky staf të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën 2017-2018. Per sa me siper, ju informojme qe shoqeria "Inerti" shpk disponon te punesuar ne pozicionin e arkitektit Z. Th. N., i cili pasqyrohet edhe ne licencen e shoqerise qe mban daten 07.12.2017. Ky fakt vertetohet nga dokumentacioni i paraqitur ne tender per punonjesin ne fjale si dhe nga licenca e shoqerise "Inerti" shpk. Ne kushte te tilla pika 2.3.1 eshte permbushur nga shoqeria "Inerti" shpk.

Lidhur me pretendimin e dyte te AK, ky i fundit si pjese te kapacitetit teknik ka kerkuar:

15 Impiant prodhim betoni me QKL pronësi ose qira Copë 1

16 Impiant prodhim inertesh me QKL pronësi ose qira Copë 1

Per te plotesuar kriterin e mesiperme shoqeria "Inerti" shpk ka paraqitur kontratat e furnizimit si me poshte vijon:

1. Kontraten periodike te furnizimit date 28.06.2018 me shoqerine Elira shpk

2. Kontraten periodike te furnizimit date 05.06.2018 me shoqerine Ferro-Beton shpk

3. Kontraten periodike te furnizimit date 13.11.2017 me shoqerine E&E Ndertim shpk

Per sa me siper, theksojme qe qellimi i Autoritetit Kontraktor eshte qe te sigurohet qe cdo operator ekonomik te disponoje materialet e duhura per realizimin e objektit qe do te prokurohet. Ne rastin konkret, kontrata e furnizimit si një kontratë e veçantë e pranuar nga Kodi Civil, konkretisht Neni 772 e ne vazhdim, jep garanci të plota për Autoritetin Kontraktor për mundësinë e disponimit të furnizimit me materialet e kërkuara. Arsyetimet e Autoritetit Kontraktor nuk duhet te dalin jashte qellimit te objektit te tyre. Shoqeria "Inerti" shpk disponon nje dokument me fuqi juridike, ne formen e nje marreveshje furnizimi, i cili verteton nje marredhenie midis dy subjekteve juridik, e cila ka per qellim perfitimin e nje materiali (beton ose inerte per rastin konkret) i cili do ti sherbeje nevojave te shoqerise per realizimin e objektit te prokurimit. Kontrata e Qirase dhe e Furnizimit, si qellim baze kane sigurimin dhe disponimin e nje materiali ose lende dhe per rastin ne fjale ndryshimi qendron thjesht ne menyren si sigurohet materiali dhe nuk cenon disponueshmerine e ketij te fundit. Konkretisht, ne kontraten e qirase, operatori ekonomik angazhohet vet ta realizoj te gjithe procesin e punes deri ne prodhimin e lendes baze (duke perdorur nje objekt ne pronesi te dikujt tjeter kundrejt nje pagese te percaktuar), dhe tek kontrata e furnizimit Operatori ekonomik gezon te drejten e perfitimit te furnizimit te vazhdueshem dhe periodik me lenden baze te kerkuar kundrejt nje pagese te percaktuar. Konstatojme qe ne te dyja rastet e kontratave, qellimi i Operatorit ekonomik eshte i njejte, perfitimi i lendes baze per realizimin e projektit objekt prokurimi. Ndodhur perballe nje fakti te tille, kur shoqeria "Inerti" shpk disponon disa marreveshje per realizimin e marrjes se lendes beton dhe inerte, atehere gjykojme qe skualifikimi i bere nga Autoriteti Kontraktor eshte teresisht i padrejte. Autoriteti Kontraktor perdor argumenta qe bien ndesh me qellimin e zhvillimit te procedures prokuruese duke mos gjykuar ne menyre te drejte kapacitetet e operatoreve ekonomik. Kriteret kushtezuese qe vendos AK jane diskriminuese per disa operatore dhe favorizuese per operatoret e tjere konkurrenente. Gjithashtu, ne kuader te skualifikime te padrejta te operatoreve me oferta me te favorshme, duhet te permendim faktin qe kualifikimi i nje operatori me vlere diferencialisht me te larte sjell deme te konsiderueshme ne buxhetin e shtetit, deme te cilat duhet tu behen te njohura dhe te ndiqen nga organet kompetente.

Per sa me siper kerkojme kualifikimin e shoqerise "Inerti" shpk [...]"

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 7480/2 Prot., datë 10.09.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "Inerti" sh.p.k., duke e pranuar pjesërisht ankesën, me argumentimin si më poshtë vijon:

"[...]"

Argumenti i Komisionit te Shqyrtimit te Ankesave.

Per kete Komisioni i shqyrtimit te Ankesave ne lidhje me pretendimin tuaj per piken 2.3.1, shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ne kete procedure dhe konstaton se operatori ka paraqitur kontrate pune, CV dhe diplome per Arkitektin si dhe eshte drejtues teknik ne licencen e shoqerise, per kete Gjykojme se ankimuesi ka te drejte.

...shoqeria "INERTI" ka paraqitur kontraten e furnizimit si me poshte vijon. 4. Kontrate periodike te furnizimit date 28.06.2018 me shoqerine "Elira shpk"

5. Kontrate periodike tefurnizimit date 05.06.2018 me shoqerine "Ferro Beton shpk" 6. Kontrate periodike te furnizimit date 13.11.2017 me shoqerine "E&E Ndertim shpk".

Gjykon se, ne lidhje me piken 2.3.3 Si dëshmi për mjetet & pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion Operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë: ...Impiant prodhim betoni me QKL, pronësi ose qira, copë 1; Impiant prodhim inertesh me QKL, pronësi ose qira, cope 1. Sipas dokumentacionit te paraqitur, te shoqerise pjesemarrese ne kete procedure, rezulton qe per keto kapacitete teknike jane paraqitur kontrata furnizimi, kjo ne kundërshtim me kriterin e dhene ne dokumentet e tenderit, ku ne VKM 914, date 29.12.2014 Rregullat e Prokurimit Publik" i ndryshuar, ne nenin 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" pika 3 shprehet ", komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Komisioni i shqyrtimit te ankesave e gjykon te drejte Vendimin e Komisionit le Vleresimi! te Oferlave per skualifikim.

Pretendimijuaj nuk qendron pasi nuk plotesoni kriteret e kerkuara ne DST. [...]"

II.7. Në datën 19.09.2018 operatori ekonomik ankimues "Inerti" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të lënë në fuqi nga autoriteti kontraktor, në të cilën argumenton si më poshtë vijon:

"[...]Ne arsyet e skualifikimit te shoqerise "Inerti" shpk, Autoriteti Kontraktor ka pretenduar se nuk eshte permeshur kriteri i pikes 2.3.1, ne te cilin citohej shprehimisht:

Si staf inxhinierik (drejtues teknikë) të përfshirë në licencën e shoqërisë të jenë:

1 IngNdërtimi

1 Ing. Elektrik

1 Ing. Hidroteknik

1 Ing. Mjedisi

1 Ing. Mekanik

1 Arkitekt

Të paraqiten: kontratat e rregullta të punës, diplomat dhe CV-të. Ky staf të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën 2017-2018. Konkretisht nga Autoriteti Kontraktor pretendohej qe nuk ishte paraqitur arkitekti si drejtues teknik duke munguar dokumentacioni i tij.

Arsyeja e dyte e skualifikimit ka gene lidhur me kapacitetitin teknik te kerkuar:

15 Impiant prodhim betoni me QKL pronësi ose qira Copë 1

16 Impiant prodhim inertesh me QKL pronësi ose qira Copë 1

pasi AK pretendon qe shoqeria Inerti shpk nuk ka paraqitur kontrate qiraje.

Per te plotesuar kriterin e mesiper shoqeria "Inerti" shpk ka paraqitur kontratat e furnizimit si me poshte vijon:

1. Kontraten periodike te furnizimit date 28.06.2018 me shoqerine Elira shpk

2. Kontraten periodike te furnizimit date 05.06.2018 me shoqerine Ferro-Beton shpk

3. Kontraten periodike te furnizimit date 13.1.2017 me shoqerine E&E Ndertim shpk.

Ne date 04.08.2018 shoqeria Inerti shpk ka depozituar Ankese prane Autoritetit Kontraktor, Autoritetit Rrugor Shqiptar, i cili ne date ne date 10.09.2018 kane kthyer pergjigje duke pranuar vetem nje nga kundërshtimet e shoqerise Inerti shpk, lidhur me paraqitjen e dokumentacionit te arkitektit ne dosjen e tenderit dhe duke rrezuar piken e dyte te ankimit lidhur me paraqitjen e kontrates se furnizimit.

Per sa me siper theksojme qe qellimi i Autoritetit Kontraktor eshte qe te sigurohet qe cdo operator ekonomik te disponoje materialet e duhura per realizimin e objektit qe do te prokurohet.

Ne rastin konkret, kontrata e furnizimit si një kontratë e veçantë e pranuar nga Kodi Civil, konkretisht Neni 772 e ne vazhdim, jep garanci të plota për Autoritetin Kontraktor për mundësinë e disponimit të furnizimit me materialet e kërkuara. Arsyetimet e Autoritetit Kontraktor nuk duhet të dalin jashtë qëllimit të objektit të tyre. Shoqëria “Inerti” shpk disponon një dokument me fuqi juridike, në formën e një marrëveshje furnizimi, i cili verteton një marrëdhënie midis dy subjekteve juridik, e cila ka për qëllim përfitimin e një materiali (beton ose inerte për rastin konkret) i cili do të shërbejë nevojave të shoqërisë për realizimin e objektit të prokurimit. Kontrata e Qirase dhe e Furnizimit, si qëllim baze kanë sigurimin dhe disponimin e një materiali ose lende dhe për rastin në fjale ndryshimi qëndron thjesht në mënyrën si sigurohet materiali dhe nuk cenon disponueshmerinë e këtij të fundit. Konkretisht, në kontratën e qirase, operatori ekonomik angazhohet vet ta realizoj të gjithë procesin e punës deri në prodhimin e lendes baze (duke përdorur një objekt në pronësi të dikujt tjetër kundrejt një pagese të percaktuar), dhe tek kontrata e furnizimit Operatori ekonomik gëzon të drejtën e përfitimit të furnizimit të vazhdueshëm dhe periodik me lenden baze të kërkuar kundrejt një pagese të percaktuar. Sipas përcaktimeve të bëra në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Kreu IV Furnizimi, neni 772, është dhënë përkufizimi i saktë i kontratës së furnizimit ku citohet: Furnizimi është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet, kundrejt pagesës së një çmimi, të kryejë në dobi të palës tjetër furnizime periodike ose të vazhdueshme të sendeve. Sendet e furnizuar mund të jenë të luajtshme ose të paluajtshme, gjithashtu mund të jenë në trajtë energjie ose titujsh krediti. Ndërkohë që, po ashtu është në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Kreu VI, Qiraja, neni 801, është dhënë përkufizimi i kontratës së qirasë ku citohet: Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t’i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar. Në këtë kuptim, furnizimi me beton në nocionin juridik nuk mund të jetë një kontratë qiraje, pasi në përfundim të afatit të kontratës së qirasë, rrjedhimisht nënkupton që duhet të kthejme betonin tek qiradhënësi duke qënë se është në gëzim të përkohshëm. Kërkesa e Autoritetit Kontraktor, si dhe arsyeja e skualifikimit për paraqitje kontrate qiraje për furnizim me beton dhe jo kontratë furnizimi sic është paraqitur nga ana jonë, nuk përbën as sens logjik dhe as sens juridik. Gjithashtu, po në Kodin Civil kreu II, Interpretimi i Kontratës, neni 681, citon: Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qënë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës. Që do të thotë, qëllimi i furnizimit me beton nga ana jonë është përmbushur duke respektuar dhe dokumentat standarte të Autoritetit Kontraktor. Konstatojmë që ne të dyja rastet e kontratave, qëllimi i operatorit ekonomik është i njëjti, përfitimi i lendes baze për realizimin e projektit objekt prokurimi. Ndodhur përball një fakti të tillë, kur shoqëria “Inerti” shpk disponon disa marrëveshje për realizimin e marrjes së lendes beton dhe inerte, atëherë gjykojmë që skualifikimi i bere nga Autoriteti Kontraktor është teresisht i padrejte.[...]”

II.8. Në datën 28.09.2018 nëpërmjet shkresës me nr. 8271/1 prot., datë 28.09.2018, me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentacioni dhe informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Inerti” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Inerti" sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyen: "Nuk eshte permbushur pika: 2.3.3 Si dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë ...Impiant prodhim betoni me QKL, pronësi ose qira, copë 1; Impiant prodhim inertesh me QKL, pronësi ose qira, copë 1. Sipas dokumentacionit të paraqitur, te shoqerise pjesemarrëse ne kete procedure, rezulton qe per keto kapacitete teknike jane paraqitur kontrata furnizimi, kjo ne kundërshtim me kriterin e dhene ne dokumentet e tenderit", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12, pika 2.3. Kapaciteti teknik, pika 2.3.3., nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

"2.3.3 Si dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet minimumi 10 ton	pronësi ose qira	Copë 2
2	Autopompë hedhje betoni	pronësi ose qira	Copë 1
3	Motobetoniere kantieri (0,25 m ³)	pronësi ose qira	Copë 3
4	Autobetoniere	pronësi ose qira	Copë 1
5	Vinc kulle	pronësi ose qira	Copë 1
6	Motosaldatrice	pronësi ose qira	Copë 1
7	Pompë suvatimi	pronësi ose qira	Copë 2
8	Autobot uji 5000 litra	pronësi ose qira	Copë 1
9	Gjenerator	pronësi ose qira	Copë 1
10	Matrapik	pronësi ose qira	Copë 3
11	Vibrator	pronësi ose qira	Copë 1
12	Tabela kantieri	pronësi ose qira	Copë 10
13	Karro dore	pronësi ose qira	Copë 10
14	Skeleri	pronësi ose qira	1300 m ²
15	Impiant prodhim betoni me QKL	pronësi ose qira	Copë 1
16	Impiant prodhim inertesh me QKL	pronësi ose qira	Copë 1

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit, dhe foto e tij.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes /cdoganimi, fotot dhe fatura tatimore përkatëse.

Kur mjetet / pajisjet teknike janë me qira, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qirasë (për gjithë periudhën e objektit të prokurimit) dhe bashkëlidhur te gjithë dokumentet e përshkruar më sipër, sipas përkatësisë.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të kriterëve të mësipërme, rezulton se ka dorëzuar:

- Shtojca 10 Mbi disponimin e mjeteve, ku në tabelën e mjeteve "me qera" deklarohet:
 - fabrikë asfaltbetoni – kontratë me Ferro – Beton

- fabrikë asfaltbetoni – kontratë me Elira shpk
 - nyje për material inerte – kontratë me E & E Ndërtim.
- Kontratë porosie e lidhur në datën 05.06.2018, ndërmjet shoqërisë “Ferro – Beton & Construction Co” sh.p.k. në cilësinë e furnizuesit dhe shoqërisë “Inerti” sh.p.k. në cilësinë e porositësit, për furnizimin me beton, shoqëruar me certifikatë regjistrimi lëshuar nga QKR, Leje lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës - QKL, leje ndërtimi, vendimi i KRRT, akt miratimi – Autorizim mjedisor, planimetri;
 - Kontratë furnizimi e lidhur në datën 28.06.2018, ndërmjet shoqërisë “Elira” sh.p.k. në cilësinë e furnizuesit dhe shoqërisë “Inerti” sh.p.k. në cilësinë e porositësit, për furnizimin me materialin asfalt; kontratë furnizimi ndërmjet shoqërisë “Spartaku” sh.p.k. dhe “Elira” sh.p.k., ekstrakti i regjistrimit tregëtar i shoqërisë “Spartaku” sh.p.k., dokument zhdoganimit, leje e lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës - QKL, akt miratimi – leje mjedisore, foto, harta treguese, planimetria,
 - Kontratë furnizimi e lidhur në datën 13.11.2017 ndërmjet shoqërisë “E & E Ndërtim” sh.p.k. në cilësinë e furnizuesit, me shoqërinë “Inerti” sh.p.k. në cilësinë e porositësit, për furnizimin me në kohë e me cilësi me inerte sipas çdo kërkesë nga ana e këtij të fundit, certifikatë regjistrimi, ekstrakti i regjistrimit tregëtar i shoqërisë “E & E Ndërtim” sh.p.k., vendimi i ortakut të vetëm, licencë, leje e lëshuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes - QKL, leje ndërtimi, leje për rehabilitimin e shtratit lumor, vendim nga këshilli i basenit ujqor Mat, leje për përdorim të burimit ujqor, vendim, harta topografike, vërtetim, leje mjedisi, leje për rehabilitim shtrati lumor, vendim nga këshilli i basenit ujqor Mat, harta treguese, certifikatë regjistrimi, harta treguese, vendim, certifikatë për vërtetim pronësie, kartela e pasurisë, leje ndërtimi, leje për përdorim të burimit ujqor, certifikatë për vërtetim pronësie,

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.1.4. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.1.5. Në nenin 26 “Kontratat për punë publike”, pika 8 gërma “c” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një interpretim të zgjeruar të nenit 46 pika 1 gërma “b” të LPP-së dhe nenit 26 pika 8 gërma “c” të aktit normative në zbatim të ligjit VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike) i nenit 46 pika 1 gërma “b” K.P.P. gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që me anë të dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë të vërtetohet plotësimi i kapacitetit teknik të tyre në drejtim të kapaciteteve organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. Akoma më tej, në nenin 26 pika 8 gërma “c”, parashikohet se për përmbushjen e kapacitetit teknik operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet të vlerësojë në mënyrë sipërfaqësore duke iu referuar vetëm regjimit juridik të dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë, në rast se me anë të dokumentacionit të dorëzuar vërteton se ka në pronësi, qera apo disponueshmëri me mjete të tjera juridike të paisjeve dhe aseteve të cilat ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion për zbatimin me sukses të kontratës.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se për plotësimin e kapacitetit teknik në drejtim të vërtetimit të disponueshmërisë së linjës së inerteve dhe të betonit ka dorëzuar kontratat e furnizimit si më sipër cituar, me anë të së cilave, shoqëritë furnizuese, kanë marrë përsipër furnizimin e shoqërisë “Inerti” sh.p.k. me “materiale inerte, betoni, asphalt etj., për ndërtim”, shoqëruar me leje mjedisore QKL, çertifikata pronësie, fatura doganore etj., për vërtetimin e aktit të pronësisë.

Sa më sipër, K.P.P. gjykon se me anë të kontratës së furnizimit, si një kontratë e veçantë e pranuar nga Kodi Civil, e cila jep garanci të plota për autoritetin kontraktor për mundësinë e disponimit të furnizimit me materialet e kërkuara janë përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor pasqyruar në kriteret e veçanta të kualifikimit, si edhe në zbatim të nenit 46 pika 1 gërma “b” të LPP-së dhe nenit 26 pika 8 gërma “c” të VKM 914/2014.

III.1.9. Për më tepër, autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë se, operatorët ekonomikë ofertues në kontratat e punëve publike për ndërtimin/rikonstruksionin/mirëmbajtjen e objekteve të ndryshme janë shoqëri tregtare ndërtuese, të cilat jo domosdoshmërisht duhet të disponojnë në pronësi impiante të tilla. Në rastin e punëve publike, të cilat kanë nevojë për volume të konsiderueshme të materialeve të ndërtimit (beton apo asfalt) dhe në rastet kur, ofertuesi nuk i ka në pronësi impiantet automatikë të prodhimit të materialeve të nevojshme për realizimin e punimeve të ndërtimit të objektit, referuar legjislacionit në fuqi, mund t’i disponojë ato me kontratë qeraje ose kontratë furnizimi për materialet me disponuesit e impianteve, ku kjo e fundit, është një kontratë e veçantë që jep garanci për disponimin e materialeve sipas kërkesave të autoritetit kontraktor dhe sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, me anë të dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike, operatori ekonomik plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit e njëherazi vërteton se disponon/gëzon mundësinë e disponimit të mjeteve të kërkuara për zbatimin e kontratës në zbatim të nenit 26 pika 8 gërma "c" të VKM 914/2014.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Inerti" sh.p.k. për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur", me objekt "Rikonstrukcion i godinës së ARSSH-së", me nr. REF-77899-07-04-2018, me fond limit 33.312.381 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.08.2018, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik "Inerti" sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Inerti" sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1510 Protokolli

Datë 19.09.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Enkeleda Bega	Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha